



# NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE PUBLIC HOUSING ENTERPRISE

Adr: Rr. "Xhevdet Doda" nr. 32 - Prishtinë-Kosovë  
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446  
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: 02 - 214/11

Data: 14. 02. 2020

Në bazë të dispozitave të nenit 21, të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), nenit 26.3.3 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A, në Prishtinë, në takimin e mbajtur më datë: **13 shkurt 2020**, nxorri këtë:

## V E N D I M

- I. Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Banesore Sh.A. me seli në Prishtinë, përzgjedhet z. **Hajdar Hoxhaj**, i lindur më 15 dhjetor 1982 në Gjakovë, me profesion ekonomist.
- II. Paga e Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. në Prishtinë, caktohet në bazë të dispozitave të nenit 22 të Ligjit Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike.
- III. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore t'i kryejë të gjitha procedurat e parapara me Rregulloren nr.01-2724 datë 03.12.2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin me përshkrim të detyrave të punës të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. Prishtinë.

## A r s y e t i m

Në bazë të konkursit të rishpallur me datën **23 Dhjetor 2019** në gazetën e përditshme "Koha Ditore" për pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Banesore, kanë aplikuar 16 kandidatë për këtë pozitë, nga të cilët 11 kandidatë i kanë plotësuar kriteret e konkursit për të vazhduar në fazën e intervistimit. Bordi i Drejtorëve me mbështetjen e përfaqësuesve të Ambasadës Britanike ka bërë vlerësimin e përbashkët për secilin kandidat. Pas procedurës së intervistimit në bazë të listës përfundimtare të poentimit Bordi i Drejtorëve ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicojë procedurën e konfliktit administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi.



Inicimi i procedurës të konfliktit administrativ nuk e pezullon ekezekutimin e këtij vendimi.

**Ky vendim i dorëzohet:**

- Të përzgjedhurit
- Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve
- Burimeve Njerëzore
- Arkivit të Ndërmarrjes

Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Banesore Sh.A



Lendita Mekuli Myderizi

Arbnora Jashanica

Bekim Pireva

Xhevdet Leci

